Në komunën e Drenasit, shërbimet sociale ofrohen nepërmjet Qendres për Punës Sociale (QPS) me gjithsej 11 zyrtarë të punësuar, nga të cilët 4 janë të angazhuar në ofrimin e shërbimeve sociale. Sa i përket ofrimin të shërbimeve sociale, sfida mbetet mungesa e një hapësire për qëndrim ditë apo shtëpi të pleqëve, andaj ndërtimi dhe funksionalizimi i një qendre ditore apo shtëpie për pleqtë duhet të jetë një nga prioritetet e Komunës së Drenasit gjatë 5 viteve të ardhshme.



AMBIENTI DHE SHËRBIMET PUBLIKE

Ambienti dhe shërbimet publike

Menaxhim i mbeturinave

Sipas të dhënave të AMMK (Agjensioni për Menaxhim të Mbeturinave), gjatë vitit 2016 në komunën e Drenasit kanë qenë afërsisht 11,118 klientë që janë shërbyer nga kompania për menaxhimin e mbeturinave. Aktualisht nuk ka të dhëna të besueshme dhe të verifikuara për sasinë e mbeturinave që gjenerohen në komunën e Drenas. Për më tepër, vlen të theksohet që Drenasi përdor stacion të transferit të mbeturinave.

Sistemi i grumbullimit të mbeturinave karakterizohet nga shkalla e lartë (70%) e mbulimit territorial me shërbim të mbledhjes së mbeturinave, megjithatë frekuenca e mbledhjes së mbeturinave në zonat rurale mbetet e ulët.

Ndër prioritetet më të rëndësishme sa i përket menaxhimit të mbeturinave në komunën e Drenasit është edhe zgjerimi i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave për tërë territorin e komunës duke përfshirë të gjitha ekonomitë familjare në sistem të Menaxhimit të Mbeturinave, si dhe eliminimi i vazhdueshëm i deponive ilegale. Vlen të shtohet që, klasifikimi, mbledhja dhe transferimi i mbeturinave specifike si p.sh.: me prejardhje shtazore, medicinale, të ngurta, etj., mbetin edhe më tutje sfidë për sektorin e menaxhimit të mbeturinave në komunën e Drenasit.

Infrastruktura

Në bazë të të dhënave nga sistemi ARIS që posedon Komuna e Drenasit, deri më tani janë identifikuar gjithsej 778 rrugë me një gjatësi prej 597 km rrugë, prej të cilave rreth 58% e rrugëve janë të asfaltuara, 0.4% janë me kubëza dhe 41.6% e rrugëve janë me zhavorr. Gjatë vlerësimit infrastrukturor nëpërmjet sistemit GIS është evidentuar se shumica e vendbanimeve janë të asfaltuara apo kubëzuara, ndërsa pjesa tjetër e rrugëve me zhavorr janë kryesisht rrugica të shkurtra.

Në anën tjetër, sa i përket trotuareve, kanalizimit fekal dhe atmosferik, ujësjellësit dhe ndriçimit të rrugëve, ka pasur përparim, megjithatë mbetet në nivele më të ulëta se sa asfaltimi.

Deri më tani nga 597 km rrugë 8% e tyre janë të inventarizuara me trotuare, 46% e tyre kanë kanalizim fekal, dhe vetëm 5% janë të ndriçuara. Ndërsa, sa i përket ujësjellësit, nga gjithsej 43 vendbanime vetëm 15 prej tyre (në qytet dhe zona urbane) janë të përfshira në rrjetin e ujësjellësit.




Figura 22 Infrastruktura publike sipas %

Mirëmbajtja e infrastrukturës publike mbetet ndër sfidat kryesore. Aktualisht, Komuna e Drenas nuk ka ndonjë sistem të menaxhimit të infrastrukturës në funksion të evidentimit të saktë të dëmtimeve dhe nevojave për intervenim. Kompanitë publike, private dhe qytetarët shpesh kryejnë punime duke bërë dëmtime të theksuara në infrastrukturën publike. Në këtë drejtim Komuna duhet të monitorojë dhe inspektojë më intensivisht kompanitë dhe qytetarët për respektimin e lejeve që kanë ndikim në infrastrukturën publike.



KULTURA, SPORTI DHE TURIZMI

Kultura, Sporti dhe Turizmi

Kultura

Komuna e Drenasit ka traditë të gjatë në kultivimin dhe zhvillimin e kulturës dhe artit. Në komunën e Drenasit veprojnë tri shoqëri kulturo-artistike: ShKA "Panajot Kanaqi", ShKA "Shotë Galica" dhe ShKA "Ymer Alushani". Ndër aktivitetet më të rëndësishme kulturore që tradicionalisht organizohen në Drenas, vlen të përmendën: "Ditët e Mërgatës"; Sofra poetike "Ymer Elshani"; Revista Folklorike Burimore Shqiptare; Festivali "Ditët e humorit Drenasi", etj.

Në komunën e Drenasit numërohen gjithsej 6 objekte kulturore:

- 4 Biblioteka (Biblioteka në Drenas, Komoran, Terstenik dhe Arllat)
- 1 Qendër Rinore (Qendra Rinore në Drenas), dhe
- 1 Sallë e Kulturës (Salla e Kulturës në Drenas).

Nga të gjitha bibliotekat në komunën e Drenasit, thuajse asnjëra prej tyre nuk i plotëson kushtet teknike, ndërsa mangësi tjetër shumë e theksuar është që asnjëra prej tyre nuk ka qasje për persona me aftësi të kufizuar. Për më tepër, asnjëra nga bibliotekat e komunës së Drenasit nuk ka bërë digjitalizimin e librave ekzistues. Sa i përket Qendrës Rinore, ajo është objekt shumë i vjetër dhe aktualisht është jashtë funksionit, ka pjerrina për persona me aftësi të kufizuar vetëm në përdhese, ndërsa qasja në kat nuk është e mundur (nuk posedon ashensorë apo pjerrinë). Salla e kulturës posedon kapacitet prej 310 ulësesh, mirëpo ka shumë mungesa nga aspekti teknik: mungesë të projektorit, zërimit, ndriçimit dhe skenës profesionale.

Përveç investimeve të nevojshme në infrastrukturën përcjellëse në objektet kulturore, është shumë me rëndësi për kulturën e Drenasit ndërtimi dhe funksionalizimi i Muzeut Etno-kulturor të qytetit. Si rrjedhojë, në kuadër të këtij objekti, të funksionojë edhe arkiva e qytetit me kushte adekuate për arkivim afatgjatë. Për më tepër, procesi i digjitalizimit të Arkivës së Qytetit është një vlerë e shtuar për ruajtjen e vlerave kulturore dhe historike të Drenasit.

Sporti

Sporti është një nga sektorët më të zhvilluar në komunën e Drenasit, aktualisht janë 31 klube të regjistruara sportive. Sa i përket infrastrukturës sportive, aktualisht komuna e Drenasit posedon vetëm një palestër sportive që kryesisht përdoret nga klubet sportive për stërvitje dhe zhvillim të ndeshjeve. Gjatë këtyre viteve Komuna ka investuar në ndërtimin e hapësirave sportive në qytet dhe fshatra megjithatë njëra ndër sifdat mbetet shtegu i atletikës, ndërtimi dhe funksionalizimi i pishinës olimpike, etj.

Aktualisht në komunën e Drenasit janë gjithsej 6 objekte sportive:

- Stadiumi i qytetit "Rexhep Rexhepi" në Drenas
- Palestra sportive në Drenas
- Stadiumi sintetik në Drenas dhe

- 3 fusha sintetike: Damanek, Polluzhë, Komoran.

Ndër aktivitetet më të rëndësishme sportive të cilat organizohen në komunën e Drenasit, vlen të përmendën: Turnire për nder të festave kombëtare dhe shtetërore, Krosi Komunal Pranverorë-Vjeshtorë, garat e pionerëve dhe të rinisë shkollore, manifestimi për zgjedhjen e sportistit të vitit, turnir memorial-traditional në futboll, etj. Poashtu, çdo vit klubet sportive subvencionohen nga Komuna e Drenasit. Komuna e Drenasit vazhdimisht u ofron ndihmë klubeve sportive përmes këshillimeve profesionale, subvencionimit të kuotizimit dhe licencimit të klubeve, dhe krijimit të hapësirave të mjaftueshme për stërvitje dhe zhvillim të ndeshjeve. Për më tepër, në vazhdimësi ka përkrahur financiarisht klubet dhe shoqatat sportive.

Sfidë mbetet mirëmbajtja e objekteve sportive, fushave sportive në fshatra, dhe rritja e kapaciteteve infrastrukturore në zhvillim të sportit në komunën e Drenasit.

Turizmi

Komuna e Drenasit karakterizohet me mundësi të shumta të zhvillimit të turizmit kulturor dhe rural. Viset malore siç janë Çyçavica, Vargmalet e Berishës e Kosmaçi e rrisin potencialin konkurrues për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në komunën e Drenasit

Vendet me potencial të lartë turistik dhe atraktive për zhvillimin e turizmit si Kalaja e Verbovcit, Liqeni i Vasilevës, lumenjtë Drenica dhe Verbica, Gryka e “Gurit të Plakës”. Guri i Gradinës, Kalaja e Vuçakut, Pishat e Gllobarit etj. paraqesin disa nga burimet e rëndësishme për zhvillimin e turizmit në Drenas.

Për më tepër, rritja e investimeve dhe promovimi i shpellave sikurse janë: Shpella e Peshterrit në Nekovc, Shpella e Kizharekës, Shpella e Kokilit në Verboc, Shpella e Baicës dhe Shpella e Gllanasellës, do të ndikonte në rritjen e vizitave turistike nga turistë vendor dhe të huaj. Poashtu, komuna e Drenasit ka një trashëgimi mjaft të pasur kulturore me objekte ose monumente të trashëgimisë kulturore, të periudhave të ndryshme historike si Kalaja e Verbovcit dhe Kalaja e Vuçakut etj.

Në bashkëpunim me agjensione dhe operatorë turistikë vendor dhe ndërkombëtar duhet të zhvillohen dhe promovohen paketa të reja turistike. Përveç kësaj, rekomandohet të bëhet listimi i të gjitha atraksioneve turistike dhe të trashëgimisë kulturore në platformat online siç janë: Trip Advisor, Four Square, Wikipedia, etj. Gjithashtu, të bëhet shënjëzimi dhe digjitalizimi i shtigjeve të vrapimit dhe ecjes malore.

ADMINISTRATA

ADMINISTRATA

Administrata komunale në Drenas është e organizuar nëpërmjet 12 drejtorive të cilat janë themeluar me statutin e Komunës. Aktualisht janë të punësuar 141 persona prej të cilëve 61% meshkuj dhe 39% janë femra.

Në bazë të të dhënave nga Drejtoria e Administratës, 37% e të punësuarve në administratë komunale janë të moshës mbi 56 vjeçare, 21% i takojnë grupmoshës 46-55 vjeç. Numri më i lartë i të punësuarve nga grupmosha mbi 56 vjet i përkasin nivelit profesional dhe administrativ, kurse 37 të punësuar janë me nivel të edukimit të mesëm.




Figura 23 Numri i punëtorëve sipas nivelit të edukimit dhe kategorisë funksionale

Trajnimet dhe Zhvillimi

Njëra nga kompetencat kyçe të menaxhimit të personelit të administratës është trajnimi dhe zhvillimi i resurseve njerëzore. Nëpërmjet trajnimeve dhe programeve për zhvillim Komuna duhet t'u siguroj punonjësve mjetet e nevojshme për suksesin e tyre, që në shumë raste, do të thotë t'u ofrojnë punonjësve trajnime të vazhdueshme për t'i ndihmuar ata në punët e tyre.

Komuna e Drenasit në bashkëpunim me donatorë të ndryshëm ia ka mundur stafit komunal pjesëmarrjen në kurse dhe programe të ndryshme të trajnimit. Megjithatë, është shumë e rëndësishme që Komuna të analizojë në vazhdimësi kapacitetet e stafit nëpërmjet vlerësimit të nevojave për trajnim. Nëpërmjet këtij vlerësimi bëhet përcaktimi i aftësive të nevojshme që duhet t'i ketë stafi për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara, për të vlerësuar nivelin aktual të aftësive dhe shkathtësive të stafit, por edhe për të kuptuar boshlleqet e paraqitura ndërmjet aftësive të nevojshme dhe atyre ekzistuese. Pastaj, bazuar në raportin e vlerësimit të nevojave për trajnim, Komuna duhet të zhvillojë programin e trajnimeve me qëllim të ngritjes së performancës së punonjësve.

Sistemet e menaxhimit

Sa i përket menaxhimit të qeverisjes nëpërmjet sistemeve elektronike, qeverisja komunale në Drenas viteve të fundit ka funksionalizuar sisteme të menaxhimit dhe monitorimit elektronik:

- ✓ sistemin për menaxhimin e resurseve njerëzore;
- ✓ sistemin e hyrje daljeve të të punësuarve; dhe

- ✓ intranetin dhe sistemin e protokolimit elektronik.

Megjithatë, është me rëndësi që të zhvillohen dhe avansohen sistemet menaxhuese në mënyrë që të lehtësohet edhe procesi i planifikimit, duke përfshirë: sistemin elektronik të menaxhimit të projekteve i bazuar në praktikën në legjislacionin kosovar dhe praktikën ndërkombëtare, azhurnimi i platformës ARIS me kadastrin nëntokësor dhe të dhënat tjera, sistemi i menaxhimit dhe monitorimit të inspektimeve, etj. Poashtu, është shumë e nevojshme që të bëhet edhe zhvillimi dhe implementimi i standardit për menaxhimin e cilësisë ISO 9001:2015, në funksion të rritjes së efikasitetit të menaxhimit, kontrollit dhe operimit.

Ofrimi i shërbimeve

Ofrimi i shërbimeve publike administrative për qytetarët, bizneset dhe OJQ-të në forme të certifikatave, vendimeve, aktvendimeve, pëlqimeve, etj., është njëri ndër obligimet kryesore të komunës. Komuna e Drenasit ofron rreth 100 shërbime publike administrative për qytetarët, bizneset dhe OJQ-të. Këto shërbime i ofron edhe nëpërmjet të zyrave të gjendjes civile.

Sa i përket digjitalizimit të ofrimit të shërbimeve, aktualisht vetëm disa certifikata mund të ofrohen përmes E-Kioskës së vendosur në hyrje të ndërtesës së komunës, kurse të gjitha shërbimet tjera ofrohen në mënyrë fizike, ku gjithashtu edhe mënyra e aplikimit është e tillë. Në këtë drejtim, në bashkëpunim me donatorë komuna e Drenasit duhet të bëjë përpjekje që të bëjë digjitalizimin e ofrimit të shërbimeve publike administrative për qytetarët e saj, të funksionalizojë 'one-stop-shop' për ofrimin e shërbimeve, si dhe të rris numrin e E-Kiosqeve dhe numrin e shërbimeve në zyrat e gjendjes civile.

Plani Strategjik dhe Operacional

Vlerat

Shtatë parimet udhëzuese në vijim janë vlera që pasqyrojnë bindjet tona për rolet dhe përgjegjësitë e komunës sonë:

(1) PUNA EKIPORE

Ne punojmë së bashku në mënyrë efektive brenda komunës për të arritur qëllimet e përbashkëta në mënyrë efektive dhe efikase;

(2) TRANSPARENT

Ne u përgjigjemi qytetarëve tanë me përgjegjësi dhe i ofrojmë shërbimet tona në mënyrë profesionale dhe transparente;

(3) KOMUNIKUES

Ne raportojmë para publikut mbi suksesin tonë në përmbushjen e qëllimeve tona dhe mirëmbajmë komunikimin edhe me gjithë palët e interesit;

(4) LLOGARIDHËNËS –

Ne jemi të përgjegjshëm dhe transparent ndaj publikut për rolet, funksionet dhe veprimet tona si individë dhe si komunë;

(5) INOVATIV –

Ne jemi kreativ, mësojmë nga përvoja dhe rezultatet dhe kërkojmë mënyra të reja dhe efikase për të zgjidhur problemet dhe për t'i shërbyer qytetarëve;

(6) PROFESIONAL

Ne mbështetemi në standarde të larta, aftësi, kompetenca dhe integritet gjatë kryerjes së detyrave tona në komunë;

(7) TË PAANSHËM DHE TË DREJTË

Ne u shërbejmë të gjithë banorëve të komunës sonë duke promovuar drejtësi dhe mundësi dhe duke eliminuar pabarazitë.

Vizioni

Drenasi çeles i zhvillimit.

Misioni

Komuna e Drenasit model i zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik për mirëqenie për të gjithë

Objektivat Strategjike dhe Hapat Kryesor

1. **ZHVILLIM I QËNDRUESHËM EKONOMIK.** Përmirësim i vazhdueshëm i ambientit të sektorit privat dhe nxitje e zhvillimit të hovshëm dhe të qëndrueshëm ekonomik me qëllim të gjenerimit të punësimit me vlerë.

Ky qëllim strategjik mund të arrihet, në mes tjerash, përmes implementimit efektiv dhe eficient, dhe të rritjes së hovshme, substanciale si dhe të qëndrueshme të këtyre nën-qëllimeve strategjike dhe Nën-objektiva / Projekte / Hapave kryesor:

1.1. Investime publike infrastrukturore që përmirësojnë ambientin e të bërit biznes

1.1.1. Krijimi i kushteve infrastrukturore për krijimin e zonës së dytë ekonomike deri në fund të vitit 2024, më së paku 1000 të punësuar brenda 5 viteve.

- 1.1.1.1. Zhvillimi i Studimit të Fizibilitetit për Zonën Ekonomike, deri në fund të vitit 2020
- 1.1.1.2. Krijimi i infrastrukturës dhe ndarja e parcelave në bazë të raportit të fizibilitetit, deri në fund të vitit 2023
- 1.1.1.3. Ndërtimi dhe funksionalizimi i Zonës Ekonomike, deri në fund të 2024

1.2. Stimulimi i zhvillimit ekonomik përmes Investimeve të Huaja Direkte ('IHD')

1.2.1. Tërheqja e investimeve të huaja në shumë prej 10 milion deri në fund të vitit 2024.

- 1.2.1.1. Evidentimi i nivelit (sektorët, nr. i punëtorëve, qarkullimi) të investimeve aktuale, deri në fund të vitit 2020
- 1.2.1.2. Identifikimi i së paku 70 investitoreve potencial, deri në mars 2021
- 1.2.1.3. Krijimi i kontakteve me së paku 20 IHD të përzgjedhur, deri në shtator 2021
- 1.2.1.4. Pjesëmarrja në së paku 2 konferenca investive deri në fund të 2022
- 1.2.1.5. Organizimi i konferencës investive në Drenas, me së paku 10 IHD potencial, deri në fund të 2021

1.3. Nxitja e inovacionit përmes Partneriteteve Publiko Private (PPP)

1.3.1. Inicimi i 3 projekteve PPP dhe implementimi / përfundimi me sukses i njërit prej tyre, deri në fund të 2024

- 1.3.1.1. Ngritja e Grupit Punues (GP) për PPP.
- 1.3.1.2. Ngritja e kapaciteteve për PPP.
- 1.3.1.3. Identifikimi i projekteve për PPP.
- 1.3.1.4. Përzgjedhja e 3 projekteve potenciale për PPP.
- 1.3.1.5. Sigurimi i fondeve për financimin e Studimeve të Fizibilitetit për projektet e përzgjedhura të PPP.
- 1.3.1.6. Hartimi i studimit të fizibilitetit për 3 projekte në PPP.

1.4. Zvogëlimi i deficitit tregtar përmes rritjes së konkurrueshmërisë dhe eksportit të kompanive vendore.

1.4.1. Të rritet eksporti për 30% deri në fund të vitit 2024 (rritje 6% në vit)

- 1.4.1.1. Evidentim i nivelit (sektorët, nr. i punëtorëve, qarkullimi) të eksportit aktual, deri në fund të vitit 2020
- 1.4.1.2. Në bashkëpunim me donatorë do të përkrahen nga 5 biznese në vit (eksportuesit dhe prodhuesit të gatshëm për eksport) në rritjen e konkurrueshmërisë së tyre për treg të jashtëm (vlerësimi i gatishmërisë për eksport, plane të hyrjes në tregje të huaja, deri në fund të vitit 2024.

1.5. Rritja e prodhimit lokal (zëvendësim i importit)

1.5.1. Rritja e prodhimit të prodhuesve dhe përpunuesve nga 5% për çdo vit deri në fund të vitit 2024.

- 1.5.1.1. Rritja e sipërfaqeve të pemishteve (me fokus në fruta arrimore) për 3% në vit deri në fund të 2024
- 1.5.1.2. Funksionalizimi i rrjetit të furnizimit me ujë të kanaleve të ujitjes deri në fund të vitit 2024
- 1.5.1.3. Rritja e subvencioneve/granteve për ngritjen e pemishteve dhe perimeve me varietete të vonshme, si dhe për përkrahje të blegtorisë dhe bletarisë nga 5% në vit.
- 1.5.1.4. Ngritja e kapaciteteve të fermerëve të Drenasit përmes qendrës informuese, organizimi i së paku 5 takime informuese në vit
- 1.5.1.5. Dizajnimi i modulit të faqes aktuale të Komunës për këshilla bujqësore dhe publikimi i videove këshilluese për secilën veprimtari bujqësore, deri në fund të vitit 2021
- 1.5.1.6. Përmirësimi i imazhit të prodhuesve vendor përmes promovimit të produkteve të Drenasit, përfshirë artizanatet, çdo vit nga 1 panair për promovimin e produkteve

1.6. Nxitja e ndërmarrësisë tek të rinjtë, përmes hapjes së bizneseve të reja ('startups') të qëndrueshme.

1.6.1. Të krijohen kushte për hapjen e 500 bizneseve të reja (Start-Up) deri në fund të vitit 2024, me së paku 200 të punësuar në vit.

- 1.6.1.1. Evidentim i gjendjes aktuale (sektorët, nr. i punëtorëve, qarkullimi, eksporti) të bizneseve të reja, deri në fund të vitit 2020
- 1.6.1.2. Përkrahja e së paku 3 bizneseve në vit përmes subvencioneve, granteve për start up, bizneset prodhuese dhe shërbyese me prioritet gratë ndërmarrëse
- 1.6.1.3. Funksionalizimi i Inkubatorit aktual të Parku i Biznesit deri në maj të vitit 2021
- 1.6.1.4. Fasilitasi i krijimit të 20 bizneseve të reja në vit, dhe 50 të rinjë në vit të ndjekin punë praktike. Prioritet do t'i jepet lëmive: IT-së, teknik të instalimeve, dhe përpunimit të lëndëve të para
- 1.6.1.5. Ofrimi i konsulencave/këshillimeve në vazhdimësi për bizneset

1.7. Zhvillimi i turizmit në komunën e Drenasit përmes atraksioneve turistike

1.7.1. Krijimi i kushteve për zhvillim të turizmit në komunën e Drenasit deri në fund të vitit 2024

- 1.7.1.1. Zhvillimi i kapaciteteve pritëse-akomoduese në fshatra (Dobroshec, Verboc, Vasileve, Vuqak, Poklek), së paku 5 kapacitete deri në fund të vitit 2021
- 1.7.1.2. Identifikimi dhe inventarizimi elektronik e fizik i shtigjeve për ecje dhe vrapim malor
- 1.7.1.3. Vendosja e sinjalistikës informuese për vizitorë (tabela informuese, tabela për shtigje, monumente të trashëgimisë, etj.)
- 1.7.1.4. Përgatitja e pakove turistike, së paku 3 pako turistike, përfshirë video promovuese, deri në fund të vitit 2020 (identifikimi i zonave turistike/monumenteve kulturore natyrore)
- 1.7.1.5. Listimi i të gjitha atraksioneve turistike dhe natyrore në platformat online të promovimit të turizmit si: TripAdvisor; Google; Wikipedia; Viator;

2. **ZHVILLIM I QËNDRUESHËM SOCIAL.** Fuqizimi i qytetarëve për ta realizuar potencialin e tyre të plotë, përmes sigurimit të mundësive të barabarta në arsim, shëndetësi dhe jetë sociale cilësore.

Ky qëllim strategjik mund të arrihet, në mes tjerash, përmes këtyre nën-qëllimeve strategjike, projekteve dhe hapave kryesorë

2.1. Përmirësimi i kushteve të jetesës

2.1.1. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore përmes asfaltimit dhe kubëzimit të rrugëve të pashtruara, deri në fund të 2024

- 2.1.1.1. Asfaltimi dhe kubëzimi i së paku 100 km rrugë deri në fund të vitit 2024
- 2.1.1.2. Në bashkëpunim me donatorë dhe me institucionet qendrore të bëhet zgjerimi i infrastrukturës së rrjetit hekurudhor, Fushë Kosovë - Aeroport - Parku i Biznesit - Drenas, deri në fund të 2024

2.1.2. Funksionalizimi i ndriçimit publik në lagjet dhe fshatrat e pandriçuara, deri në fund të vitit 2024

- 2.1.2.1. Instalimi i trupave ndriçues në së paku 100 km rrugë në lagje dhe fshatra të Drenasit, deri në vitin 2024

2.1.3. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatra

- 2.1.3.1. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në 5 fshatra dhe kycja e të gjitha familjeve, deri në fund të 2024

2.1.4. Rritja e hapsirave për këmbësorë

- 2.1.4.1. Deri në vitin 2022 përfundojnë të gjitha trotualet përgjatë shkollave, ambulanteve dhe institucioneve publike.

2.2. Sistem gjithëpërfshirës dhe llogaridhënës i arsimit, me menaxhim cilësor dhe mësimdhënës të përgatitur, me mjedise krijuese dhe kushte që sigurojnë edukim dhe arsim cilësor për nxënës.

2.2.1. Ngritje e kapaciteteve të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) në planifikim strategjik dhe monitorim, deri në mars 2020.

- 2.2.1.1. Zhvillimi dhe aprovimi i planit komunal për zhvillim të arsimit 2021-2025, deri në fund të 2020.
- 2.2.1.2. Trajnim i stafit të DKA-së për 'Planifikim Strategjik dhe Operacional', deri në mars 2020.
- 2.2.1.3. Përmirësimi i kapaciteteve për të mbledhur, analizuar dhe menaxhuar të dhënat relevante për ngritjen e cilësisë dhe rritjen e qasjes në arsim, deri në maj 2020.
- 2.2.1.4. Hartimi i rregullorës brenda shkollave deri në mars 2020

2.2.2. Përmirësimi i cilësisë në menaxhim dhe mësimdhënie, përmes vlerësimit sipas metodologjisë '360°', ku nxënësit vlerësojnë mësimdhënësit, mësimdhënësit menaxhmentin e shkollës, dhe menaxhmenti i shkollës mësimdhënësit, nga qershori i 2021 dhe pastaj çdo vit.

- 2.2.2.1. Adoptimi i metodologjisë për vlerësim bazuar në rregullat në fuqi deri në qershor 2020.
- 2.2.2.2. Informimi i mësimdhënësve, nxënësve dhe menaxhmentit të shkollave për metodologjinë dhe procesin e vlerësimit deri në janar 2021.
- 2.2.2.3. Organizimi i vlerësimit të mësimdhënësve, menaxhmentit të shkollave nga qershori deri në tetor 2021.
- 2.2.2.4. Analizimi i rezultateve të vlerësimit dhe përgatitja e planit për përmirësim bazuar në rezultatet deri në janar 2022.
- 2.2.2.5. Ceremonia vjetore e përzgjedhjes së top drejtorëve të shkollave, mësimdhënësve dhe nxënësve, bazuar në rezultatet e vlerësimit, duke filluar nga tetori i vitit 2021 dhe më pas çdo vit.

2.2.3. Përmirësimi i menaxhimit të shkollave, përmes funksionalizimit dhe trajnimit të së paku 70% të këshillave drejtues të shkollave (për 'rolet dhe funksionet' e këtyre këshillave), deri në fund të 2021.

- 2.2.3.1. Zhvillimi i programit të trajnimit për rolet, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave të shkollave deri në qershor 2020.
- 2.2.3.2. Përgatitja e kalendarit të trajnimeve për këshillat drejtues të shkollave deri në gusht 2020.
- 2.2.3.3. Organizimi i të paktën 30 ditë trajnimi sipas kalendarit të aprovuar deri në fund të 2021.
- 2.2.3.4. Standardizimi i raporteve të takimeve dhe diskutimeve të këshillave drejtuese të shkollave
- 2.2.3.5. Publikimi i rregullt i raporteve të punës së këshillit drejtues

2.2.4. Përmirësimi i cilësisë në arsim, përmes funksionalizimit të shërbimeve pedagogjike dhe psikologjike, mjekësore, stafit asistent mbështetës dhe mësuesit mbështetës në të paktën 70% të shkollave, deri në fund të 2024.

- 2.2.4.1. Përzgjedhja e pedagogëve dhe psikologëve në shkolla sipas udhëzimeve administrative të MASHT-it, për çdo vit të rritet 10-15% mbulimi i shkollave.
- 2.2.4.2. Për çdo vit, të bëhet organizimi i trajnimeve për pedagogët dhe psikologët e rinjë në shkolla lidhur me ofrimin e shërbimeve efikase, rolin dhe funksionin e tyre.
- 2.2.4.3. Ngritja e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të shërbimeve pedagogjike dhe psikologjike, bazuar në rregullat në fuqi, deri në qershor 2020.
- 2.2.4.4. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi i rregulltë mbi punën e shërbimeve pedagogjike dhe psikologjike në shkolla.
- 2.2.4.5. Identifikimi i shkollave ku ka fëmijë të integruar me nevoja të veçanta
- 2.2.4.6. Rekrutimi i stafit mbështetës dhe mësuesve mbështetës
- 2.2.4.7. Trajnimi i stafit mbështetës për trajtim të nxënësve me nevoja të veçanta.

2.2.5. Përmirësimi i cilësisë në arsim, përmes rritjes së aftësive të së paku 70% të koordinatorëve të cilësisë në monitorim të zbatimit të kurrikulës së re, në vit.

- 2.2.5.1. Zhvillimi i programit të trajnimit (përfshirë formatin e raportimit) për koordinatorët e cilësisë për monitorim, vlerësim të kurrikulës së re deri në qershor 2020.
- 2.2.5.2. Standardizimi i raporteve të vlerësimit
- 2.2.5.3. Publikimi i raporteve të rregullta të vlerësimit
- 2.2.5.4. Organizimi i së paku 1 trajnimit në vit për koordinatorët e cilësisë në shkolla për monitorim, vlerësim dhe raportim.

2.2.6. Bashkërendimi i arsimit dhe aftësimit profesional dhe teknik me nevojat e tregut të punës, deri në 2022.

- 2.2.6.1. Identifikimi i nevojave të tregut të punës përmes hulumtimit të bazuar në takime me kompani prodhuese dhe përpunuese të sektorëve të ndryshëm ekonomik, deri në fund të 2020.
- 2.2.6.2. Krijimi i drejtimeve të reja të aftësimit profesional dhe teknik në bazë të nevojave (dhe rishikimi i atyre ekzistuese), të identifikuara të tregut dhe trendeve të zhvillimit ekonomik dhe sektorial, deri në qershor 2021.
- 2.2.6.3. Rekrutimi dhe sistemimi i kuadrit të nevojshëm mësimor për implementimin e drejtimeve të reja të aftësimit teknik dhe profesional, deri në fund të gushtit 2021.
- 2.2.6.4. Fasilitasi i vazhdueshëm i shkollave profesionale në lidhjen e memorandumeve të bashkëpunimit me kompani lokale për kryerjes e praktikës profesionale nga nxënësit e drejtimeve teknike dhe profesionale
- 2.2.6.5. Furnizimi i vazhdueshëm me material shpenzues për laboratore dhe kabinete në shkollën profesionale
- 2.2.6.6. Inventarizimi dhe funksionalizimi i së paku 2 kabineteve në shkollën profesionale, deri në fund të vitit 2023

2.2.7. Përmirësimi, rritja dhe/ose pajisja me teknologji dhe mjete konkretizuese të hapsirave fizike për mësim dhe praktikë, respektivisht laboratorëve kimike / biologjike, kompjuterike, sportive, përmirësimi i oborreve shkollore, si dhe ndërtimi i shkollave të reja, deri në fund të 2022.

- 2.2.7.1. Përmirësimi, rritja dhe/ose pajisja me teknologji dhe mjete konkretizuese të hapsirave fizike për mësim dhe praktikë, të laboratoreve kimike / biologjike në shkolla
- 2.2.7.2. Përmirësimi, rritja dhe/ose pajisja me teknologji dhe mjete konkretizuese të hapsirave fizike për mësim dhe praktikë, të laboratoreve kompjuterike në të paktën 5 shkollat: "Rasim Kicina", "7 Marsi", "Bajram Curri", "Luigj Gurakuqi", "Shaban Polluzha".
- 2.2.7.3. Përmirësimi, mirëmbajtja, rritja dhe/ose ndërtimi i terreneve sportive në të paktën 3 shkolla: Kishnarekë, Verbovc dhe Cikatove e Vjetër.
- 2.2.7.4. Përfundimi i të gjitha rrethojave të oborreve të shkollave dhe rregullimi i tyre me kënde të lojërave edukative.
- 2.2.7.5. Ndërtimi i 1 shkolle të re
- 2.2.7.6. "Ndërtimi i të paktën 4 salla të edukatës fizike në shkollat me numër të madh të nxënësve deri në 2024, në: SHML "Skënderbeu", SHMU "Bajram Curri", SHMU "Ali Gashi", SHMU "Abedin Bujupi".
- 2.2.7.7. Nxitja e punës praktike të nxënësve në shkollën profesionale nëpërmjet punës së tyre/projekteve infrastrukturore komunale (p.sh: ndërtimi i rrethojave të shkollave)

2.2.8. Arsimit gjithëpërfshirës dhe i barabartë për të gjithë

- 2.2.8.1. Ndërtimi dhe funksionalizimi i 4 çerdheve të bazuar në komunitet në Komoran, Terstenik, Arllat dhe Baicë.
- 2.2.8.2. Funksionalizimi i çerdhes në Drenas 3, të bazuar në komunitet.
- 2.2.8.3. Të përfundoj ndërtimi dhe të funksionalizohet ndërtimi i çerdhes në Drenas 1 deri në fund të vitit 2021

2.3. Shërbime shëndetësore cilësore që u mundësojnë qytetarëve të kenë shëndet të mirë fizik dhe mendor

2.3.1. Përmirësimi i infrastrukturës në objektet shëndetësore në QMF dhe Ambulantave të Mjeksisë Familjare (AMF), deri në fund të vitit 2024

- 2.3.1.1. Të përfundoj ndërtimi dhe të funksionalizohet ndërtimi i çerdhes në Drenas 1 deri në fund të vitit 2021
- 2.3.1.2. Renovimi i brendshëm dhe rregullimi i hapësirave të jashtme të të paktën 2 institucione shëndetësore ekzistuese, deri në fund të 2022.
- 2.3.1.3. Zgjerimi i hapësirave për shërbimet në QMF për ordinancat stomatologjike në Arllat.
- 2.3.1.4. Ndërtimi i pjerrinave për PAK (Personat me Aftësi të Kufizuara)
- 2.3.1.5. Rregullimi i nyjeve sanitare në të gjitha objektet e institucioneve shëndetësore.
- 2.3.1.6. Instalimi i ngrohjeve qendrore eficiente në të gjitha objektet e AMFve dhe QMFve.

2.3.2. Rritja e numrit të shërbimeve laboratorike në QKMF, QMF dhe AMF, nga janari 2022.

- 2.3.2.1. Pajisja e QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve me pajisje të nevojshme laboratorike për kryerjen e analizave biokimike dhe hematologjike të gjakut dhe analizave të urinës, deri në fund të 2021.

2.3.3. Deri në fund të vitit 2020 të përfundoj zonimi

- 2.3.3.1. Hartimi dhe aprovimi i planit sektorial të shëndetësisë
- 2.3.3.2. Identifikimi dhe krijimi i listës së pacientëve
- 2.3.3.3. Sistematizimi i punëtorëve të shëndetësisë
- 2.3.3.4. Rritja e numrit të stafit profesional në mjekësi familjare
- 2.3.3.5. Krijimi i kartelave fizike dhe elektronike të pacientëve

2.3.4. Deri në fund të vitit 2023 të gjitha institucionet shëndetësore të pajsen me pajset mjekësore sipas Udhëzimeve Administrative në fuqi

- 2.3.4.1. Furnizimi me aparaturë mjekësore 8 EKG; 11 defibrilator bifazik; 3 defibrilator mobil gjysëmautomatic, 7 Sterelizator, dhe 3 Monitor për përcjelljen e parametrave Vital. (në TM2 2020: 2 Def+ 2 Mob.; 4EKG; dhe 3Monitor. Në TM3 2021 4 Sterelizator)
- 2.3.4.2. Furnizimi me frigoriferë (ruajtja e zingjirit të ftohtë) – (2 frigoriferë në TM3 2020, kurse 2 frigoriferë në TM2 2021)
- 2.3.4.3. Funksionalizimi i laboratorit në QMF Gllanasellë dhe në Tërstenik. (2 Numrues hematologjik, 2 aparata biokimik, 2 Mikroskopa) – Në TM4 2020 në Terstenik, kurse në TM4 2021 në Gllanasellë.
- 2.3.4.4. Marrëveshja me operatorin për mirëmbajtjen dhe kalibrimin e paisjeve mjekësore (kontratë kornizë 2 vjeçare)

2.3.5. Rritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore përmes praktikave të mira të monitorimit dhe vlerësimit kosto-efektiv

- 2.3.5.1. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të protokolleve klinike
- 2.3.5.2. Kryerja e rregullt e auditeve klinike nga ekspert të jashtëm

2.3.6. Shtrirja e shërbimeve të shëndetit oral në të gjitha QMF-të deri në fund të 2022

- 2.3.6.1. Rekrutimi i stomatologëve të rinjë
- 2.3.6.2. Blerja e të paktën 3 karrigeve stomatologjike dhe pajisjeve përcjellëse

2.3.7. Rritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore nëpërmjet rishikimit të statutit të QKMF-së dhe hartimit të rregullores së brendshme të QKMF-së deri në fund të 2020

- 2.3.7.1. Ngritja e grupeve punuese për rishikim të statutit dhe hartim të rregullores së brendshme të QKMF-së
- 2.3.7.2. Hartimi i rregullores së brendshme dhe rishikimi i statutit të QKMF-së

2.4. Jetesë më të dinjitetshme për të gjithë qytetarët.

2.4.1. Ofrimi i kushteve për jetesë të dinjitetshme familjeve pa strehim adekuat, deri në fund të 2024.

- 2.4.1.1. Në bashkëpunim me donatore, të ndërtohen të paktën 2 shtëpi çdo vit për familjet pa strehim adekuat, në deri në 2024.
- 2.4.1.2. Në bashkëpunim me donatorë, të renovohen së paku 2 shtëpi nën kushte minimale për banim për familjet në nevojë deri në 2024
- 2.4.1.3. Renovimi i ndërtesave të banimit të përkohshëm social deri në 2023
- 2.4.1.4. Përcaktimi i mirëmbajtjes së objekteve të banimit të përkohshëm social bazuar në Ligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit

2.4.2. Funksionalizimi i hapsirës adekuate për strehimin / banimin dhe përkujdesjen e 30 pleqve mbi 65 vjeç, raste sociale që nuk kanë asnjë të ardhur financiare, deri në fund të 2022.

- 2.4.2.1. Zhvillimi i planit të ndërtimit, funksionalizimit dhe operimit të 'Shtëpisë së Pleqve' (SHP), hapsirë për strehimin dhe përkujdesjen ndaj pleqve që kategorizohen si raste sociale, deri në maj të 2020.
- 2.4.2.2. Sigurimi i financimit për ndërtimin e SHP, deri në fund të 2021.
- 2.4.2.3. Ndërtimi i SHP, deri në fund të 2022.
- 2.4.2.4. Funksionalizimi i SHP-së deri në fund të vitit 2023

2.4.3. Funksionalizimi i hapsirës adekuate për qëndrim dhe përkujdesje ditore të pleqve, deri në fund të 2022.

- 2.4.3.1. Zhvillimi i planit të ndërtimit, funksionalizimit të 'Qendrës së Kujdesit Ditor për Pleq' (QKDP), deri në maj të 2020.
- 2.4.3.2. Sigurimi i financimit për ndërtimin e QKDP, deri në fund të 2020.
- 2.4.3.3. Ndërtimi i QKDP, deri në fund të 2022.

2.4.4. Përmirësimi i kushteve në ofrimin e shërbimeve sociale.

- 2.4.4.1. Krijimi i hapësirës për takimet mes prindërve dhe fëmijëve në kuader të QPS-së
- 2.4.4.2. Alokimi i fondit emergjent për rastet emergjente sociale.

2.5. Rini e shëndoshë, Kulturë dhe Sport të Zhvilluar

2.5.1. Ndërtimi dhe funksionalizimi i një objekti Muzeut të qytetit dhe Arkivit

- 2.5.1.1. Sigurimi i hapësirës adekuate për ndërtim të Muzeut dhe Arkivit, deri në prill 2020.
- 2.5.1.2. Sigurimi i financimit për ndërtimin e objektit të Muzeut dhe Arkivit, deri në fund të 2020.
- 2.5.1.3. Ndërtimi dhe inventarizimi i objektit të Muzeut dhe Arkivit, deri në shtator 2022.
- 2.5.1.4. Mbledhja e artefakteve historike deri në fund të 2023
- 2.5.1.5. Ngritja e kapaciteteve të menaxhmentit dhe stafit, deri në dhjetor 2022.

2.5.2.

2.5.3. Ndërtimi i 10 Terreneve Sportive (TS) në fshatra dhe në lagje, dhe mirëmbajtja e atyre ekzistuese, deri në fund të 2024.

- 2.5.3.1. Sigurimi i hapësirave adekuate për ndërtim të TS-ve, deri në fund 2020.
- 2.5.3.2. Sigurimi i financimit për ndërtimin e TS-ve, deri në janar të 2021.
- 2.5.3.3. Ndërtimi 10 TS-ve, deri në fund 2024
- 2.5.3.4. Përzgjedhja e një Operatori Ekonomik (OE) për mirëmbajtjen e TS-ve, deri në fund të 2020 / nëpërmjet PPP

2.5.4. Bibloteka Publike e Drenasit me fond të mjaftueshëm të librave dhe menaxhim të qëndrueshëm

- 2.5.4.1. Regjistrimi i fondit të librave dhe menaxhimi elektronik i tyre
- 2.5.4.2. Rritja e fondit të librave për 20% çdo vit.
- 2.5.4.3. Rritja e hapësirave për lexim në objektin e bibliotekës publike në Drenas

3. **MENAXHIM I QËNDRUESHËM.** - Menaxhim efikas dhe eficient i komunës, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të menaxhimit njerëzor dhe financiar, bazuar në praktikat e mira ndërkombëtare të qeverisjes lokale.

Ky qëllim strategjik mund të arrihet, në mes tjerash, përmes këtyre nën-qëllimeve strategjike, projekteve dhe hapave kryesorë

3.1. Zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese për përmirësim të vazhdueshëm të performancës së Komunës

3.1.1. Themelimi dhe funksionalizimi i komisionit për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të SZHEL, deri në mars 2020.

- 3.1.1.1. Nxjerrja e një vendimi nga Kryetari i Komunës për emërimin e Komisionit (5-7 anëtarë) , përfshirë përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi.
- 3.1.1.2. Përgatitja e metodologjisë për kryerjen e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Strategjisë

3.1.2. Zbatimi Planit të Integritetit dhe menaxhimit të rreziqeve

- 3.1.2.1. Monitorimi dhe raportimi (çdo 3 Muaj) tek Kuvendi Komunal për zbatimin e Planit të Integritetit dhe menaxhimit të rreziqeve
- 3.1.2.2. Plotësim-ndryshimi i planit për Integritet dhe Menaxhim të rreziqeve

3.1.3. Zhvillimi dhe implementimi i sistemit për menaxhimin e cilësisë 'ISO 9001:2015', deri në fund të 2020.

- 3.1.3.1. Analizimi i gjendjes aktuale të sistemit të menaxhimit të cilësisë brenda komunës

- 3.1.3.2. Identifikimi i nevojave dhe kërkesave për përmirësim të proceseve të brendshme.
- 3.1.3.3. Ndërtimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas kërkesave të standardit ndërkombëtare ISO 9001:2015 (manuali i cilësisë; procedurat e cilësisë; politika dhe objektivat e cilësisë; përgatitja e Komunës për certifikim sipas standardit ISO 9001:2015).
- 3.1.3.4. Funksionalizimi i sistemit dhe proceseve të hartuara.
- 3.1.3.5. Auditimi i brendshëm para-çertifikues.
- 3.1.3.6. Çertifikimi nga trupa e jashtme audituese

3.1.4. Krijimi dhe funksionalizimi i sistemit për menaxhim të projekteve, deri në fund të 2021.

- 3.1.4.1. Instalimi dhe funksionalizimi i softverit për menaxhim të projekteve
- 3.1.4.2. Trajnimi i menaxherëve të kontratave/projekteve për përdorim të softverit

3.1.5. Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të stafit të Komunës

- 3.1.5.1. Themelimi i një fondi për trajnimin e stafit të Komunës
- 3.1.5.2. Kryerja e Analizës së Nevojave për Trajnim
- 3.1.5.3. Përgatitja e raportit me të gjeturat dhe rekomandimet nga Analiza e Nevojave për Trajnim (ANT)
- 3.1.5.4. Përgatitja e Planit Vjetor të Trajnimit, bazuar në rezultatet e ANT.
- 3.1.5.5. Zbatimi i vazhdueshëm i Planit Vjetor të Trajnimit, përmes trajnimit të stafit të Komunës.

3.2. Ofrimi i shërbimeve publike cilësore dhe efikase për qytetarët e Komunës së Drenasit.

3.2.1. Përmirësimi i dhënies së informatave të ofruara nga “zyrtarët për shërbime me qytetarët”

- 3.2.1.1. Trajnimi i zyrtarëve për shërbime me qytetarët për ofrimin e informatave të duhura për qytetarët
- 3.2.1.2. Publikimi i informatave për shërbimet, procedurën dhe dokumentet e nevojshme në web faqen Komunës
- 3.2.1.3. Publikimi i informatave për drejtorinë dhe zyrtarët përgjegjës për ofrimin e shërbimeve publike
- 3.2.1.4. Matja e kënaqshmërisë së qytetarëve më shërbimet e ofruara

3.2.2. Ofrimi i shërbimeve përmes modelit SMART City

- 3.2.2.1. Hartimi i planit për SMART City (Digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve publike)
- 3.2.2.2. Funksionalizimi i aplikacionit mobil në funksion e ofrimit të shërbimeve digjitale

3.3. Komunikimi transparent midis Komunës dhe qytetarëve

3.3.1. Zhvillimi dhe aprovimi i politikës dhe Strategjisë Komunale për Komunikim (SKK), deri në fund të majit 2020.

- 3.3.1.1. Emërimi i një ekipi për hartimin e politikës dhe Strategjisë Komunale për Komunikim (SKK)

- 3.3.1.2. Organizimi i një punëtorie për draftimin e politikës dhe Strategjisë Komunale për Komunikim (SKK)
- 3.3.1.3. Emërimi i ekipit për monitorimin e zbatueshmërisë së politikës dhe Strategjisë për Komunikim (SKK)

3.3.2.Emërimi i ekipit për monitorimin e zbatueshmërisë së politikës dhe Strategjisë për Komunikim (SKK)

- 3.3.2.1. Standardizimi i formave të raportimit për raportet e rregullta mujore, gjashtë-mujore dhe vjetore, për secilën drejtori/sector
- 3.3.2.2. Hartimi i politikës/rregullores për përgatitjen e planeve dhe raportimin e rregullt
- 3.3.2.3. Publikimi i rregulltë i raporteve gjashtë-mujore dhe vjetore të punës në webfaqe dhe në llogarinë zyrtare të Komunës në Facebook.

3.3.3.Shpërndarja e buletinëve elektronik tremujor, duke filluar nga tremujori i tretë i 2020

- 3.3.3.1. Përgatitja e buletinëve elektronik tremujor për aktivitetet e realizuara nga drejtoritë komunale.
- 3.3.3.2. Publikimi dhe shpërndarja e buletinëve elektronik çdo tremujor përmes e-mail-it dhe platformave online

Komuna e Drenasit ::: Plani Strategjik dhe Operacional									
Plani strategjik	Plani implementues					Monitorimi		Buxheti	
Qëllimet dhe Nën-qëllimet Strategjike	Objektivat	Përgjegjës	Nën-objektiva / Projekte / Hapa kryesor ('milestones')	Periudha kohore		Indikatorët Kyç të Performancës	Vetë-financim	Donatorët	Total
				Fillimi	Mbarimi				
				d/m/v	d/m/v				

VLERAT tona!

Shtatë parimet udhëzuese në vijim janë vlera që pasqyrojnë bindjet tona për rolet dhe përgjegjësitë e komunës sonë:

(1) PUNA EKIPORE– Ne punojmë së bashku në mënyrë efektive brenda komunës për të arritur qëllimet e përbashkëta në mënyrë efektive dhe efikase;

(2) TRANSPARENT – Ne u përgjigjemi qytetarëve tanë me përgjegjësi dhe i ofrojmë shërbimet tona në mënyrë profesionale dhe transparente;

(3) KOMUNIKUES – Ne raportojmë para publikut mbi suksesin tonë në përmbushjen e qëllimeve tona dhe mirëmbajmë komunikimin edhe me gjithë palët e interesit;

(4) LLOGARIDHËNËS – Ne jemi të përgjegjshëm dhe transparent ndaj publikut për rolet, funksionet dhe veprimet tona si individë dhe si komunë;

(5) INOVATIV – Ne jemi kreativ, mësojmë nga përvoja dhe rezultatet dhe kërkojmë mënyra të reja dhe efikase për të zgjidhur problemet dhe për t'i shërbyer qytetarëve;

(6) PROFESIONAL – Ne mbështetemi në standarde të larta, aftësi, kompetenca dhe integritet gjatë kryerjes së detyrave tona në komunë;

7) TË PAANSHËM DHE TË DREJTË – Ne u shërbejmë të gjithë banorëve të komunës sonë duke promovuar drejtësi dhe mundësi dhe duke eleminuar pabarazitë.

VIZIONI: Drenasi çeles i zhvillimit.

MISIONI: Komuna e Drenasit model i zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik për mirëqenie për të gjithë

1 ZHVILLIM I QËNDRUESHËM EKONOMIK. Përmirësim i vazhdueshëm i ambientit të sektorit privat dhe nxitje e zhvillimit të hovshëm dhe të qëndrueshëm ekonomik me qëllim të gjenerimit të punësimit me vlerë.												
Ky qëllim strategjik mund të arrihet, në mes tjerash, përmes implementimit efektiv dhe eficient, dhe të rritjes së hovshme, substanciale si dhe të qëndrueshme të këtyre nën-qëllimeve												
1.1	Investime publike infrastrukturore që përmirësojnë ambientin e të bërit biznes	1.1.1	Krijimi i kushteve infrastrukturore për krjimin e zonës së dytë ekonomike deri në fund të vitit 2024, më së paku 1000 të punësuar brenda 5 viteve.	DZHE	1.1.1.1	Zhvillimi i Studimit të Fizibilitetit për Zonën Ekonomike, deri në fund të vitit 2020	Ka filluar	Dhjetor 2020	Raporti i studimit të fizibilitetit	€ 0	€ 20,000	€ 20,000
					1.1.1.2	Krijimi i infrastrukturës dhe ndarja e parcelave në bazë të raportit të fizibilitetit, deri në fund të vitit 2023	Mars 2022	Dhjetor 2024	Infrastruktura e përfunduar dhe parcelat e ndara	€ 500,000	€ 500,000	€ 1,000,000
					1.1.1.3	Ndërtimi dhe funksionalizimi i Zonës Ekonomike, deri në fund të 2024.	Mars 2023	Dhjetor 2024	Zona ekonomike e ndërtuar dhe funksionalizuar	€ 1,000,000	€ 1,000,000	€ 2,000,000
1.2	Stimulimi i zhvillimit eknomomik përmes Investimeve të Huaja Direkte ('IHD')	1.3.1	Tërheqja e investimeve të huaja në shumë prej 10 milion deri në fund të vitit 2024.	DZHE	1.3.1.1	Evidentimi i nivelit (sektorët, nr. i punëtorëve, qarkullimi) të investimeve aktuale, deri ne fund te vitit 2020	Janar 2020	Dhjetor 2020	Lista me evidencën e investimeve aktuale	€ 0	€ 0	€ 0
					1.3.1.2	Identifikimi i së paku 70 investitoreve potencial, deri ne mars 2021	Dhjetor 2020	Mars 2021	Lista me investorët potencial	€ 0	€ 0	€ 0
					1.3.1.3	Krijimi i kontakteve me së paku 20 IHD të përzgjedhur, deri ne shtator 2021	Mars 2021	Shtator 2021	Kontaktet e krijuara me investorët e përzgjedhur	€ 20,000	€ 0	€ 20,000
					1.3.1.4	Pjesëmarrja në së paku 2 konferenca investive deri në fund të 2022	Janar 2021	Dhjetor 2022	Pjesëmarrje në 2 konferenca investive	€ 10,000	€ 0	€ 10,000
					1.3.1.5	Organizimi i konferencës investive në Drenas, me së paku 10 IHD potencial, deri në fund të 2021	Janar 2021	Dhjetor 2021	Konferenca investive e organizuar në Drenas	€ 10,000	€ 20,000	€ 30,000
1.3	Nxitja e inovacionit përmes Partneriteteve Publiko Private (PPP)	1.2.1	Inicimi i 3 projekteve PPP dhe implementimi / përfundimi me sukses i njërit prej tyre, deri në fund të 2024	DZHE	1.3.1.1	Ngritja e Grupit Punues (GP) për PPP.	Janar 2020	Mars 2020	Grupi i ngritur punues për PPP	€ 0	€ 0	€ 0
					1.3.1.2	Ngritja e kapaciteteve për PPP.	Mars 2020	Korrik 2020	Numri i trajnimeve të realizuara për PPP	€ 2,640	€ 0	€ 2,640
					1.3.1.3	Identifikimi i projekteve për PPP.	Korrik 2020	Dhjetor 2020	Projektet e identifikuara	€ 0	€ 0	€ 0
					1.3.1.4	Përzgjedhja e 3 projekteve potenciale për PPP.	Janar 2021	Prill 2021	Numri i projekteve të përzgjedhura	€ 0	€ 0	€ 0
